

Në përputhje me nenin 91 të Ligjit për gjykatat, neni 68 paragrafi (5) nga Rregullorja gjyqësore dhe neni 32 nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 11.07.2024, duke vepruar mbi iniciativën për **“Përshtatjen e praktikës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, lidhur me procedurën e ngritur me kërkesën për regjistrimin në Regjistrin e avokatëve”**, nxori këtë:

## K O N K L U Z I O N

Në procedurën për gjykim në afat të arsyeshëm, në të cilën vendoset për procedurë për kryerjen e veprimtarisë së avokatëve, përkatësisht regjistrimi në Regjistrin e avokatëve të Odës së Avokatëve, zbatohet neni 6 nga Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

SEKTORI PËR GJYKIM NË AFAT TË ARSYESHËM